



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 03-02/DPK	Br. Prot. 01-1938/16
Dep.	Prot No.
Nr. I faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages 02	Date 01-06-2016
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.05.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4628/15, për z. Bajram Kolgeci, Zyrtar i Prokurimit në Universitetin Publik të Prizrenit “Ukshin Hoti”, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Bajram Kolgeci, Zyrtar i Prokurimit në Universitetin Publik të Prizrenit “Ukshin Hoti”, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat D.P.T “Drinori”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-01-658/16). Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Kolgeci, është njoftuar me fakte për gjendjen konfliktit të interesit në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, z. Kolgeci ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për të bërë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Agjencia i ka bërë shkresë paralajmërues” zyrtarit të lartë (DPKI-01-1733/16), me të cilën i është dhënë një afatë ligjor shtesë, brenda të cilës duhet të shmangët gjendja e konfliktit të interesit, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj.

Ndërkohë, zyrtari i lartë ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/1913/16), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesin privat D.P.T “Drinori”. Me këtë rast zyrtari i lartë e ka shmang gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

  
Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit